INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

KUVEND PA REND!

Organizimi dhe planifikimi i punës së Kuvendit në Legjislaturën e XI-të



NËNTOR, 2026

COPYRIGHT © 2026. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 239,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +383 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

Dizajni: envinion

Shënim: Ky raport është zhvilluar në kuadër të projektit "Të rinjtë dhe Shoqëria Civile për Integritet" (Eng: Youth and Civil Society for Integrity), i cili financohet nga Qeveria Suedeze, përmes Ambasadës së Suedisë në Prishtinë. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Institutit Demokratik të Kosovës, dhe jo doemos reflekton qëndrimet e donatorit.

Sweden
Sverige

PËRMBAJTJE

Pasqyra mujore e punës së Kuvendit të Kosovës 5


Zhvillimet kryesore 5
Planifikimi i punës dhe kalendari 6
Transparenca 6
Ligjvënia 7
Mbikëqyrja 7
Përfshirja qytetare 8
Diplomacia parlamentare 8
Sekretariati/Administrata 8

NË FOKUS: A mund një planifikim më i mirë i punës të prodhojë një dinamikë tjetër në Kuvend? 10

Kuvendi ende pa Plan Pune për sesionin vjeshtor 10
Agjenda plenare dhe bartja e çështjeve nga një seancë në tjetrën 12
Deputetët në komisione: disa në katër komisione, disa në asnjë 12
Orare të çakorduara të mbledhjeve të komisioneve 13
Përbërja e komisioneve dhe ndikimi në procesin e planifikimit 13
Kapacitetet administrative dhe mbështetja profesionale e komisioneve .. 14

*Ky raport është i strukturuar në dy pjesë. Pjesa e parë paraqet vlerësimin e punës së Kuvendit të Kosovës gjatë muajit tetor 2026, duke mbuluar zhvillimet kryesore, kalendarin dhe planifikimin e punës, aktivitetin ligjvënës dhe mbikëqyrës, funksionimin e Sekretariatit, transparencën, përfshirjen qytetare dhe diplomacinë parlamentare. Përmes këtyre kategorive synohet të ofrohet një pasqyrë e vazhdueshme dhe e krahasueshme e performancës së Kuvendit nga muaji në muaj.

Pjesa e dytë është analitike dhe i kushtohet një teme të veçantë: "Si është planifikuar dhe organizuar puna në Kuvend në fillim të kësaj legjislature", bazuar në observimet tona gjatë muajve shtator-tetor dhe nga praktikat e mëhershme që lidhen me planifikimin dhe organizimin e jetës parlamentare.



PASQYRA MUJORE E PUNËS SË KUVENDIT TË KOSOVËS

Legjislatura e XI-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës doli nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit 2026.

Procesi i konstituimit u shoqërua me vonesa dhe vështirësi në arritjen e dakordimit politik për zgjedhjen e udhëheqjes së Kuvendit. Ndonëse seanca konstituive filloi më 6 gusht 2026, zgjedhja e udhëheqjes së plotë të Kuvendit u përmbyll vetëm më 28 shtator, me zgjedhjen e Vlora Çitakut nga PDK-ja si nënkryetare e Kuvendit. Më 9 shtator, Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje! ishte zgjedhur Kryetare e Kuvendit, ndërsa më 11 dhe 13 shtator ishin zgjedhur katër nga pesë nënkryetarët, përfaqësues të LVV-së, LDK-së, Listës Serbe dhe komuniteteve joshumicë. Zvarritja e këtij procesi e shtyu formimin e plotë të strukturave drejtuese dhe organizimin e punës parlamentare, duke e bërë funksionalizimin e legjislaturës një proces të zgjatur.

Në fillim të legjislaturës u formuan gjashtë grupe parlamentare[1], ndërsa tre deputetë vazhduan pa grup parlamentar. Më 25 shtator, Kryesia e Kuvendit, së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare, diskutoi ndarjen e 16 komisioneve parlamentare. Ky diskutim shënoi fillimin e organizimit të strukturave përgjegjëse për punën ligjvënëse dhe mbikëqyrëse. Megjithatë, procesi i mëvonshëm i caktimit të anëtarëve dhe moskompletimi i përbërjes së disa komisioneve treguan se arritja e marrëveshjes për strukturat parlamentare nuk u përkthye menjëherë në funksionalizimin e plotë të tyre.

Zhvillimet kryesore

Menjëherë pas konstituimit, agjenda e Kuvendit trajtoi çështje me rëndësi për funksionimin institucional, sundimin e ligjit dhe adresimin e shqetësimeve me interes të lartë publik. Ndër vendimet kryesore ishte zgjedhja e Presidentes së Republikës së Kosovës, më 7 tetor, si dhe miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Dhomat e Specializuara. Në fund të muajit tetor, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026 dhe Ligjin për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme. Trajtimi i këtyre çështjeve pasqyron ushtrimin e funksionit vendimmarrës të Kuvendit në fusha të ndryshme, por njëkohësisht e bën të rëndësishëm shqyrtimin e përmbajtjes së vendimeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre, veçanërisht në rastet që kanë implikime të drejtpërdrejta në sundimin e ligjit dhe menaxhimin e financave publike.

Vëmendje të veçantë në agjendën parlamentare zuri edhe seanca e jashtëzakonshme e 26 tetorit, e thirrur pas vrasjes së Arlinda Zekajt, ku u trajtua përgjegjësia institucionale në adresimin e dhunës ndaj grave. Seanca përfundoi me miratimin e një rezolute dhe themelimin e një komisioni hetimor parlamentar. Përfshirja e kësaj çështjeje në agjendën e Kuvendit paraqet një mundësi për të trajtuar përgjegjësitë institucionale dhe mangësitë në reagimin ndaj rasteve të dhunës ndaj grave.

1 Në Legjislaturën e XI-të LVV ka 53 deputetë, PDK 22, LDK 18, AAK 7, Lista Serbe 9, ndërsa nga subjektet tjera 11 deputetë.

Planifikimi i punës dhe kalendari

Planifikimi i punës së Kuvendit është mbështetur kryekëput në Programin Legjislativ të Qeverisë 2026–2028, i cili përcakton projektligjet që parashihen të procedohen në Kuvend për periudhën më shumë se dy vjeçare. Gati të gjitha komisionet parlamentare, me përjashtim të dy prej tyre i kanë hartuar dhe miratuar planet e tyre të punës gjatë muajit tetor, duke u bazuar në këtë program. Megjithatë, planet individuale të komisioneve ende nuk janë konsoliduar në një plan të përgjithshëm të punës së Kuvendit. Ndërtimi i një plani të integruar të punës në fakt nuk ka qenë asnjëherë praktikë dhe kjo ia pamundëson publikut por edhe vetë Kuvendit t'a dijë cilat janë prioritetet, afatet, kapacitetet e nevojshme për trajtimin e çështjeve parlamentare dhe si do të mund të matet rezultati i punës së tyre.

Ndërtimi i një plani të integruar të punës në fakt nuk ka qenë asnjëherë praktikë dhe kjo ia pamundëson publikut por edhe vetë Kuvendit t'a dijë cilat janë prioritetet, afatet, kapacitetet e nevojshme për trajtimin e çështjeve parlamentare dhe si do të mund të matet rezultati i punës së tyre.

Transparenca

Kuvendi gjatë muajit publikoi në kalendarin zyrtar oraret e seancave plenare dhe të mbledhjeve të komisioneve, por informatat mbi orarin e mbledhjeve u publikuan zakonisht vetëm nje ditë përpara. Seancat plenare u transmetuan drejtpërdrejt, ndërsa në faqen zyrtare u publikuan përmbledhjet dhe transkriptet e tyre. Megjithatë, pavarësisht rikthimit të sistemit elektronik të votimit, votat individuale të deputetëve nuk u publikuan, duke e kufizuar mundësinë e qytetarëve për të përcjellë qëndrimet individuale të përfaqësuesve të tyre lidhur me çështjet që po trajtohen në Kuvend. Dokumentet mbi projektligjet u përditësuan në uebfaqen e Kuvendit, por jo domosdoshmërisht edhe informatat se në cilën fazë të procesit janë këto projektligje.

Mbledhjet e komisioneve u transmetuan drejtpërdrejt për publikun vetëm kur mediat kishin interes për t'i përcjellë këto mbledhje, pa një praktikë të rregullt institucionale të transmetimit. Në uebfaqe të Kuvendit u publikuan përmbledhjet e shkurtra të mbledhjeve të komisioneve, ndërsa për 59 mbledhje të mbajtura u publikuan vetëm 21 procesverbale. Mbledhjet e komisioneve vazhdojnë të incizohen por Kuvendi ende nuk ka shqyrtuar mundësinë e përdorimit të teknologjisë informative për të transkriptuar dhe publikuar përmbajtjen e diskutimeve pa vonesa. Po ashtu, nga 16 komisione parlamentare, vetëm dy kishin publikuar planet e tyre të punës. Publikimi i rregullt i procesverbaleve dhe planeve të punës do të mundësonte qasje më të drejtpërdrejtë në përmbajtjen e diskutimeve, prioritetet e komisioneve dhe nivelin e realizimit të aktiviteteve të planifikuara, duke forcuar transparencën dhe llogaridhënien parlamentare.

Ligjvënia

Gjatë kësaj periudhe, Kuvendi miratoi tetë projektligje në lexim të dytë, katër marrëveshje ndërkombëtare dhe shqyrtoi 10 projektligje në lexim të parë. Tre ligjet kryesore të cilat u miratuan ishin ai për ndryshimet në Ligjin për Dhomat e Specializuara, ndryshimet në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2026 dhe Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustifikueshme. Në nivel të komisioneve, u ndërmorën hapa për shqyrtimin e mëtejshëm të projektligjeve, përfshirë formimin e grupeve punuese për pakon e pesë projektligjeve që prekin reformat në sistemin e drejtësisë, të cilat janë edhe parakushte për të përfituar nga Plani i Rritjes i BE.

Cilësia dhe gjithëpërfshirja në procesin ligjbërës la për të dëshiruar pasi miratimi i ndryshimeve në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit u bë me shmangie nga Rregullorja dhe pa pjesëmarrjen e opozitës në votim, kurse miratimi i ndryshimeve buxhetore dhe i Ligjit për Byronë në fund të muajit u bë në një kontekst të mospajtimeve politike. Për një proces legjislativ më cilësor, është e rëndësishme që komisionet të kenë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për shqyrtimin përmbajtësor të projektligjeve dhe deputetëve t'u mundësohet debat i argumentuar me hisedarët që preken nga këto projekt-ligje para se ato të votohen.

Mbikëqyrja

Një zhvillim i rëndësishëm në aspektin e mbikëqyrjes parlamentare gjatë muajit tetor ishte themelimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e veprimeve dhe mosveprimeve institucionale lidhur me vrasjen e Arlinda Zekajt dhe trajtimin e dhunës ndaj grave dhe fëmijëve. Ky mekanizëm krijon mundësi për shqyrtimin e përgjegjësive institucionale dhe identifikimin e mangësive në reagimin ndaj rasteve të dhunës. Megjithatë, efektiviteti i tij do të varet nga ushtrimi i mandatit hetimor dhe nëse gjetjet e rekomandimet do të shërbejnë për të kërkuar përgjegjësi dhe për të nxitur masa konkrete institucionale.

Pavarësisht se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve mbetet sfida kryesore, përdorimi i instrumenteve të tjera parlamentare të mbikëqyrjes mbeti i kufizuar duke krijuar një shpërputhje midis rolit ligjvënës dhe mbikëqyrës të Kuvendit. Gjatë muajit u parashtruan 42 pyetje parlamentare ndaj ministrave dhe kryeministrit, nga të cilat deputetët morën përgjigje në vetëm 18 prej tyre. Gjithashtu nuk u zhvillua asnjë interpelancë. Në komisione u shqyrtuan raporte institucionale dhe u mbajtën raportime nga përfaqësues të Qeverisë dhe institucioneve të tjera, por në disa raste të ftuarit për raportim nuk ju përgjigjen ftesës. Megjithatë, shqyrtimi i raporteve dhe prezantimi i të dhënave nuk janë të mjaftueshme për të siguruar mbikëqyrje efektive, nëse nuk pasohen me kërkesa konkrete për llogaridhënie dhe përcjellje të zbatimit të rekomandimeve.



Pavarësisht se mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve mbetet sfida kryesore, përdorimi i instrumenteve të tjera parlamentare të mbikëqyrjes mbeti i kufizuar duke krjuar një shpërputhje midis rolit ligjvënës dhe mbikëqyrës të Kuvendit. Gjatë muajit u parashtruan **42 pyetje** parlamentare ndaj ministrave dhe kryeministrit, nga të cilat deputetët morën **përgjigje në vetëm 18** prej tyre.

Përfshirja qytetare

Në Kuvend, gjatë muajit tetor u mbajt vetëm një dëgjim publik, i organizuar nga Komisioni për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi, Tregti dhe Inovacion, lidhur me projektligjet për Energjinë dhe Energjinë Elektrike. Organizimi i vetëm një dëgjimi publik tregon për disponimin e dobët të Kuvendit për t'i konsultuar palët dhe publikun lidhur me projekt-ligjet, veçanërisht në një muaj kur Kuvendi shqyrtoi një numër të konsiderueshëm projektligjesh me ndikim në fusha të rëndësishme publike. Edhe komisionet në planet e tyre të punës, dëgjimet publike i kanë vendosur në numër shumë të vogël dhe në shpërputhje me numrin e projekt-ligjeve që po trajtojnë. Mesatarisht një dëgjim publik është planifikuar për 52 projektligje që janë proceduar nga Qeveria këtë sesion. Të vetmit mekanizma tjerë për përfshirje të ekspertëve apo organizatave të shoqërisë civile gjatë kësaj periudhe ishin shtatë grupet punuese në nivel të komisioneve, në të cilat për shkak të natyrës së punës lejojnë vetëm pjesëmarrje të kufizuar të hisedarëve.. Komisionet nuk kanë organizuar asnjë dëgjim jashtë objektit të Kuvendit për të qenë më afër me palët që preken nga ligjet.

Diplomacia parlamentare

Aktivitetet në shërbim të diplomacisë parlamentare nuk janë të koordinuara dhe nuk ka një sistem të mirëfilltë raportimi apo ndarje të informacioneve lidhur me këto aktivitete. Deputetët kanë zhvilluar takime me delegacione dhe përfaqësues ndërkombëtarë që vizituan Kuvendin dhe kanë marrë pjesë në takime dhe forume ndërkombëtare në kuadër të bashkëpunimit me institucione dhe organizata parlamentare ndërkombëtare. Megjithatë, vetë Kryesia e Kuvendit evidentoi nevojën për përmirësimin e koordinimit të këtyre aktiviteteve. Në veçanti, u theksua se deputetët duhet të koordinohen paraprakisht me Kuvendin dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për qëndrimet zyrtare që do të prezantojnë gjatë takimeve jashtë vendit. Po ashtu, u trajtua praktika e paraqitjes së kërkesave për leje udhëtimi në Kryesi pasi udhëtimet tashmë ishin realizuar.

Për adresimin e saj u prezantua një rregullore në formë të qarkores së brendshme, ndonëse nuk u sqarua nëse vonesat në procedim shkaktoheshin nga administrata apo nga vetë deputetët. Kjo tregon se, krahas zhvillimit të aktiviteteve ndërkombëtare, nevojitet një zbatim më i qëndrueshëm i procedurave të autorizimit dhe koordinimit, në mënyrë që përfaqësimi parlamentar të jetë i planifikuar, i harmonizuar dhe transparent.

Sekretariati/Administrata

Administrata e Kuvendit vazhdon të udhëhiqet me Sekretar ushtrues detyre që nga viti 2023. Kjo çështje mbetet e pazgjidhur edhe pas përfundimit të konkursit të fundit, rezultatet e të cilit u publikuan në shtator 2026. Pavarësisht kësaj, Kryesia e Kuvendit ka shtyrë marrjen e vendimit për zgjedhjen e Sekretarit të ri në çdo mbledhje të mbajtur gjatë muajit tetor. Mungesa e një vendimi përfundimtar për më shumë se tri vjet nuk është vetëm çështje e plotësimit të një pozite, por edhe e përgjegjësisë së organeve drejtuese për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të administratës së Kuvendit.

E njëjta çështje e stabilitetit administrativ vërehet edhe në nivelin e komisioneve parlamentare, ku shtatë prej tyre vazhdojnë të mbështeten nga koordinatorë me ushtrues detyre. Edhe pse këto caktime mund të shërbejnë si zgjidhje kalimtare për të garantuar vazhdimësinë e punës, përdorimi i tyre për periudha të zgjatura ngre çështje të respektimit të kufizimeve ligjore dhe të planifikimit të burimeve njerëzore. Ndryshimet e vitit 2025 në Ligjin për Zyrtarët Publik përcaktojnë kufizime kohore përfshirë afatin deri në 12 muaj për caktimin e një zyrtari si ushtrues detyre, me përjashtimet e përcaktuara me ligj, si dhe kufirin deri në dy vjet për mbulimin e një pozite të lirë në këtë mënyrë.

Në këtë kontekst, sfida e Sekretariatit nuk lidhet vetëm me plotësimin e pozitave të lira, por me nevojën për të kaluar nga zgjidhjet e përkohshme drejt një administrate të konsoliduar, me përgjegjësi dhe struktura të qarta. Kryesia duhet të përmbyllë pa vonesa të mëtejshme emërimin e Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa pozitat e koordinatorëve duhet të plotësohen përmes procedurave të rregullta, në përputhje me kornizën ligjore.

Kryesia

Mbledhje të Kryesisë	4

Seancat

Numri i seancave	6 (3 plenare, 3 të jashtëzakonshme)
Projektligje të miratuara në lexim të parë	10
Projektligje të miratuara në lexim të dytë	8
Marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara	4
Pyetje parlamentare	42
Përgjigje të kabinetit qeveritar	18
Interpelanca	0
Debate Parlamentare	0
Rezoluta/Deklarata të miratuara	1 Deklaratë dhe 1 Rezolutë

Komisionet Parlamentare

Mbledhje të komisioneve	59
Mbledhje të dështuara në mungesë kuorumi	3[1]
Dëgjime publike	1
Projektligje të shqyrtuara	16
Raporte institucionale të shqyrtuara	4
Prezantime të ministrave në komisione	4
Raportime të ministrave në Komisione	1
Raportime të institucioneve tjera në Komisione	7

1 Komisioni per Ekonomi 13 tetor dhe Komisioni për Komunitete 14 tetor dhe 21 tetor.

NË FOKUS: A MUND NJË PLANIFIKIM MË I MIRË I PUNËS TË PRODHOJË NJË DINAMIKË TJETËR NË KUVEND?

Kuvendi ende pa Plan Pune për sesionin vjeshtor

Edhe pse komisionet parlamentare kanë nisur hartimin dhe miratimin e planeve individuale të punës për sesionin vjeshtor, Kuvendi nuk ka ndërtuar dhe miratuar një plan të përgjithshëm të punës për këtë sesion përkundër që kjo është e paraparë me Rregulloren e Punës, nenin 19, paragrafin 2.2. Duke mos arritur të konsolidojë dhe miratojë një Plan të integruar, që përcakton objektivat prioritetet dhe aktivitetet për këtë vit, ose të paktën për sesionin parlamentar, Kuvendi do t'a ketë të vështirë të monitorojë apo vlerësojë përmbushjen e mandatit të tij.

Kuvendi i Kosovës ndër vite ka funksionuar pa një plan të integruar të punës. Vetëm në prill të vitit 2026, Kuvendi arriti të miratojë për herë të parë Planin e Punës për sesionin pranveror, duke shënuar një hap drejt planifikimit më të strukturuar të aktiviteteve parlamentare. Planifikimi i punës vazhdon të bëhet në nivel të komisioneve sipas një modeli të njejtë dhe të pandryshuar ndër vite. Në fillim të sesioneve parlamentare, komisionet e konsultojnë Programin Legjislativ të Qeverisë dhe në bazë të tij hartojnë plane pune, në të cilat integrojnë shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e projekt-ligjeve që bien në fushëveprimin e tyre. Gjatë ndërtimit të këtij plani, komisionet nuk sfidojnë kompleksitetin që mund të sjellë në punën e tyre volumi i ligjeve i paraparë në Agjendën Legjislative, përfshirë afatet e përcaktuara për trajtim të tyre, të cilat shpesh janë jorealiste. Për shembull, Programi Legjislativ i Qeverisë vetëm për periudhën tremujore, tetor–dhjetor 2026 parasheh procedimin e gjithsej 52 projektligjeve dhe 13 marrëveshje ndërkombëtare: 30 në tetor, 12 në nëntor dhe 23 në dhjetor.

Puna e komisioneve ndikohet nga ritmi i procedimit të projektligjeve nga Qeveria, i cili shpesh krijon vështirësi në organizimin e punës së tyre. Për shembull, Projektligji nr. 11/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit u pranua në Kuvend më 30 shtator 2026, u miratua në lexim të parë më 5 tetor dhe në lexim të dytë më 15 tetor, brenda vetëm 15 ditësh. Ky afat i shkurtër kufizoi hapësirën për shqyrtim të detajuar, konsultim me ekspertë dhe grupe të interesit, si dhe organizim të dëgjimeve publike. Prandaj, planifikimi i komisioneve duhet të marrë parasysh jo vetëm numrin e projektligjeve, por edhe kohën dhe kapacitetet e nevojshme për shqyrtimin e tyre.

Kjo mospërputhje u vërejt edhe te komisionet që ende nuk e kishin përfunduar planifikimin e punës, por duhej të trajtonin projektligje brenda afateve të përcaktuara. Kështu, më 15 tetor, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shtyu diskutimin për fushëveprimin dhe planin e punës, ndërsa në të njëjtën mbledhje shqyrtoi projektligjet për parandalimin e pastrimit të parave dhe ndryshimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2026. Kjo tregon se dinamika e procesit legjislativ ndikoi në agjendën e komisioneve, edhe para përfundimit të planifikimit të aktiviteteve të tyre organizative.

Gjatë tetorit, komisionet parlamentare u angazhuan në hartimin dhe miratimin e planeve të punës për sesionin vjeshtor. Deri më 30 tetor, 14 nga 16 komisionet shqyrtuan planet e tyre, por gjashtë prej tyre i miratuan vetëm në formë drafti, me kërkesë për plotësime të mëtejshme. Ndërkaq, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe Komisioni për Shëndetësi e shtynë shqyrtimin e planeve për mbledhjet e ardhshme.

Gjatë tetorit, komisionet parlamentare u angazhuan në hartimin dhe miratimin e planeve të punës për sesionin vjeshtor. Deri më 30 tetor, 14 nga 16 komisionet shqyrtuan planet e tyre, por gjashtë prej tyre i miratuan vetëm në formë drafti, me kërkesë për plotësime të mëtejshme. Ndërkaq, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dhe Komisioni për Shëndetësi e shtynë shqyrtimin e planeve për mbledhjet e ardhshme.

Monitorimi i procesit të planifikimit të punës nga komisionet ka treguar se komisionet vazhdojnë të planifikojnë punën e tyre sipas modeleve paraprake, pa pasë një qasje kritike apo inovative. Planet e tyre të punës janë të varfëra sa i përket nismave legjislative që burojnë nga vetë komisioni, dhe tregojnë që planifikimi është 100% i varur nga Programi Legjislativ të cilin e sjell Qeveria. Analiza e 14 planeve të miratuara tregon se aktivitetet që lidhen me shqyrtimin e projektligjeve e zënë hapësirën kryesore në këto plane. Komisioni për Legjislacion ka paraparë 12 shqyrtime të projektligjeve, Komisioni për Mjedis 10, Komisioni për Punë të Jashtme 8, ndërsa Komisioni për Ekonomi 7. Përkundër që zbatimi i ligjeve mbetet problemi më akut në vend, komisionet në përgjithësi, në planet e tyre të punës, i japin shumë pak prioritet aktiviteteve që lidhen me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve apo mbikëqyrjen e institucioneve, përfshirë këtu raportimet e ministrave dhe vizitat mbikëqyrëse në terren. Vetëm pesë komisione kanë paraparë aktivitete për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, ndërsa vizitat në terren janë paraparë nga shtatë komisione. Edhe përzgjedhja e ligjeve që do të mbikëqyren në zbatim nuk bëhet sipas një sistemi të qartë apo të bazuar në evidencë.

Për të ilustruar jokoherencën e komisioneve në rolin mbikëqyrës, shohim se Komisioni për Mjedis ka paraparë mbi tetë vizita në terren nëpër institucione të ndryshme, ndërsa Komisioni për Ekonomi ka planifikuar gjashtë shqyrtime të raporteve institucionale dhe tri raportime të ministrave. Në anën tjetër, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e ka orientuar një pjesë të konsiderueshme të punës drejt shqyrtimit të raporteve institucionale. Aktivitetet mbikëqyrëse të komisioneve kryesisht kufizohen në obligimet e rregullta për shqyrtimin e raporteve vjetore dhe raportimet e ministrave, pa u shoqëruar me iniciativa shtesë të ndërmarra nga vetë komisionet. Kjo tregon mungesë të një qasjeje më proaktive në ushtrimin e rolit mbikëqyrës. Po ashtu, në disa plane vizitat dhe takimet janë përfshirë pa u përcaktuar numri i tyre, duke e vështirësuar vlerësimin paraprak të ngarkesës dhe matjen e realizimit të aktiviteteve.

Në përfundim të sesionit parlamentar, komisionet hartojnë raporte të punës, përmes të cilave evidentojnë aktivitetet e realizuara dhe shkallën e përmbushjes së planeve të tyre të punës. Megjithatë, efektiviteti i këtij vlerësimi varet nga cilësia dhe konkretizimi i objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara paraprakisht në plane, në mënyrë që të mundësohet matja e qartë e progresit dhe identifikimi i aktiviteteve të pambuluara.

Mungesa e kalendarit mujor dhe nevoja për planifikim afatgjatë

Ndonëse Rregullorja e Punës së Kuvendit parasheh shprehimisht miratimin dhe publikimin e kalendarit mujor të punimeve, kjo praktikë ende nuk është institucionalizuar në organizimin e punës së Kuvendit. Sipas nenit 19, paragrafit 2.3, të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare, miraton kalendarin e punimeve për një muaj, i cili më pas publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit. Kjo dispozitë përcakton një mekanizëm për planifikimin paraprak të aktiviteteve parlamentare dhe koordinimin e tyre.

Në mungesë të këtij instrumenti, organizimi i punës mbështetet kryesisht në njoftime ditore ose javore. Kjo e vështirëson koordinimin e seancave plenare me mbledhjet e komisioneve dhe rrit mundësinë e mbivendosjes së aktiviteteve, veçanërisht për deputetët që janë anëtarë në disa komisione. Për më tepër, planifikimi në afate të shkurtra kufizon mundësinë për të shpërndarë në mënyrë të balancuar shqyrtimin e projektligjeve,

raportimet institucionale dhe aktivitetet mbikëqyrëse. Si rezultat, agjendat mund të përqendrohen në periudha të caktuara, ndërsa çështjet e papërfunduara barten në mbledhjet e radhës.

Përtej zbatimit të detyrimit për kalendarin mujor, Kuvendi ka nevojë për një instrument më të gjerë planifikimi në nivel të sesionit ose të vitit. Një kalendar afatgjatë do të mundësonte përcaktimin paraprak të prioriteteve, periudhave të punës plenare, shqyrtimit të projektligjeve dhe aktiviteteve të mbikëqyrjes parlamentare. Gjithashtu, do të krijonte bazë për harmonizimin e programit legjislativ të Qeverisë me kapacitetet dhe agjendën e Kuvendit, si dhe për koordinimin e planeve të komisioneve me dinamikën e përgjithshme të punës parlamentare.

Një planifikim i tillë do të rriste edhe parashikueshmërinë e punës së Kuvendit për deputetët, institucionet, shoqërinë civile, mediat dhe qytetarët, duke u mundësuar atyre të njihen me kohë me aktivitetet e planifikuara dhe të përgatiten për pjesëmarrje. Prandaj, krahas miratimit të rregullt të kalendarit mujor, Kuvendi duhet të shqyrtojë hartimin e një kalendari për secilin sesion ose për tërë vitin, i cili do të shërbente si bazë për organizimin dhe koordinimin e aktiviteteve parlamentare.

Në këtë drejtim, Kuvendi duhet të shqyrtojë edhe mundësinë e modernizimit të proceseve të planifikimit përmes teknologjisë informative dhe inteligjencës artificiale. Përdorimi i kalendarëve të integruar dhe tabelave digjitale të monitorimit, si dhe digjitalizimi i dokumenteve, arkivave dhe materialeve hulumtuese, do të mundësonin koordinim më të mirë të aktiviteteve, përcjellje më sistematike të afateve dhe matje më të saktë të rezultateve të punës parlamentare.

Agjenda plenare dhe bartja e çështjeve nga një seancë në tjetrën

Mungesa e një plani të integruar të punës së Kuvendit ka ndikim të drejtpërdrejtë në planifikimin dhe përgatitjen e mirëfillitë të seancave plenare. Sipas praktikës dhe Rregullores, Kryesia përgatit rendin e ditës së seancës së ardhshme dhe një rend të përkohshëm për seancat pasuese, në konsultim me përfaqësuesit e grupeve parlamentare dhe akterët përkatës institucionalë. Kryesia e Kuvendit mblidhet çdo të hënë, ndërsa seancat plenare zakonisht caktohen çdo të enjte, duke e organizuar punën kryesisht sipas një cikli javor. Megjithatë, kjo praktikë ngre çështjen nëse dinamika e planifikimit përshtatet me vëllimin dhe ritmin e punës legjislative të paraparë nga Qeveria. Agjenda legjislative mund të ndryshojë ndjeshëm nga një periudhë në tjetrën, si për nga numri i projektligjeve që pritet të procedohen, ashtu edhe për nga kompleksiteti dhe afatet e shqyrtimit të tyre. **Kjo praktikë përvec që ua kufizon kohën deputetëve për t'u përgatitur më mirë për shqyrtimin e pikave të seancës, nuk përshtatet as dinamikën dhe volumin e paraparë në Agjendës Legjislative të sjellur nga Qeveria.**

Një praktikë tjetër që vazhdon të përsëritet është bartja e pikave të papërfunduara nga një seancë në tjetrën kryesisht për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm për shqyrtimin ose miratimin e tyre. Një shembull është propozimi për emërimin e deputetëve në komisionet parlamentare, i cili u përfshi në agjendën e seancës së 15 tetorit, u shty në seancën e 22 tetorit për shkak të mungesës së kuorumit dhe u përfshi sërish në agjendën e 29 tetorit, pa u përmbyllur procesi. Kjo praktikë bën që çështjet e mbetura të barten vazhdimisht në agjendat pasuese, duke u shtuar pikave të reja dhe duke rritur rrezikun e mbingarkimit të rendit të ditës. Nëse kjo mënyrë e organizimit vazhdon, Kuvendi rrezikon të rikthehet te seancat me agjenda tepër të gjata, si ato të legjislaturave të kaluara, ku rendi i ditës përfshinte mbi 50 pika. Kjo jo vetëm që vështirëson planifikimin e punës plenare, por mund të ndikojë edhe në kohën dhe hapësirën që deputetët kanë në dispozicion për shqyrtimin dhe diskutimin përmbajtësor të çështjeve. Për këtë arsye, nevojitet një përcjellje më e qartë e pikave të papërfunduara dhe planifikim më realist i agjendave, duke marrë parasysh kohën e nevojshme për trajtimin e tyre.

Deputetët në komisione: disa në katër komisione, disa në asnjë

Përveç përbërjes së komisioneve, një sfidë tjetër për organizimin e punës parlamentare është shpërndarja e deputetëve ndërmjet tyre. Të dhënat e monitorimit tregojnë se 19 deputetë, apo rreth 16% e përbërjes së Kuvendit, nuk janë anëtarë të asnjë komisioni parlamentar. Nëntë prej tyre janë deputetë të Listës Serbe, propozimet për emërimin e të cilëve nuk janë përmbyllur gjatë kësaj periudhe. Ndër deputetët e tjerë që nuk janë caktuar në komisione përfshihen kryetarët e tri

partive politike Bedri Hamza, Lumir Abdixhiku, Ramush Haradinaj, nënkryetari i Kuvendit Ardian Gola dhe deputetë të tjerë Avni Dehari, Labinotë Demi-Murtezi, Vjosa Osmani, Veton Berisha dhe Adem Hodža. Të dhënat e monitorimit nuk mundësojnë përcaktimin e arsyeve për secilin rast, prandaj nuk mund të konkludohet nëse kjo lidhet me zgjedhjen e vetë deputetëve, vendimet e grupeve parlamentare apo me mënyrën e ndarjes së anëtarësive.

Në anën tjetër, disa deputetë janë anëtarë në disa komisione njëkohësisht. Albert Kinolli dhe Fridon Lala janë anëtarë në katër komisione, ndërsa Albana Bytyqi, Artan Asllani, Burim Ramadani, Ergül Mazrek, Teuta Haxhiu dhe Time Kadrijaj janë të angazhuar në nga tri komisione. Kjo shpërndarje lidhet pjesërisht edhe me përfaqësimin e partive më të vogla dhe të komuniteteve joshumicë, të cilat kanë numër më të kufizuar deputetësh dhe, për rrjedhojë, duhet t'i shpërndajnë përfaqësuesit e tyre në disa komisione për të siguruar pjesëmarrjen në fusha të ndryshme të punës parlamentare. Megjithatë, kjo krijon ngarkesë të përqendruar te një numër i kufizuar deputetësh, të cilët duhet të ndajnë kohën ndërmjet disa komisioneve dhe të përmbushin përgjegjësi të ndryshme legjislative e mbikëqyrëse.

Orare të çakorduara të mbledhjeve të komisioneve

Kjo ngarkesë bëhet edhe më e dukshme kur oraret e mbledhjeve nuk koordinohen. Gjatë monitorimit janë identifikuar të paktën tri raste të mbivendosjes së drejtpërdrejtë të mbledhjeve të komisioneve ku bënin pjesë deputetët e njëjtë. Më 13 tetor, në të njëjtën kohë u mbajtën mbledhjet e Komisionit për Buxhet dhe të Komisionit për Punë të Jashtme, ku ishte anëtare e përbashkët deputetja Ariana Musliu-Shoshi. Po atë ditë, në orën 13:00, u mbajtën njëkohësisht mbledhjet e Komisionit për Mjedis dhe të Komisionit për Administratë Publike, ku ishte anëtar deputeti Alban Bajrami. Ndërsa më 14 tetor, në orën 10:00, u mbajtën njëkohësisht mbledhjet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ku ishte anëtar deputeti Eman Rrahmani.

Përveç këtyre rasteve, janë identifikuar edhe 20 raste të tjera kur mbledhjet janë caktuar në orare shumë të afërta, duke kufizuar mundësinë e deputetëve për të marrë pjesë në të dyja, në rastet kur njëra mbledhje zgjat më shumë se intervali ndërmjet tyre. Gjatë monitorimit janë vërejtur edhe raste kur deputetët kanë arritur me vonesë në mbledhje ose janë larguar para përfundimit të tyre për të marrë pjesë në një aktivitet tjetër parlamentar.

Një faktor që ndikon në këtë situatë është edhe mënyra e caktimit të orareve të mbledhjeve të radhës. Në shumë raste, në përfundim të mbledhjes, kryetari apo kryetarja e komisionit cakton orarin e takimit të ardhshëm, pa u konsultuar paraprakisht me administratën e Kuvendit dhe pa pasur një pasqyrë të plotë të angazhimeve të deputetëve që janë anëtarë në disa komisione. Kjo praktikë e vështirëson koordinimin ndërmjet komisioneve dhe rrit mundësinë e mbivendosjes së orareve.

Këto gjetje tregojnë se planifikimi i orareve të komisioneve nuk mund të bëhet në mënyrë të ndarë nga përbërja dhe ngarkesa e deputetëve. Për këtë arsye, rekomandohet që caktimi i orareve të koordinohet nga administrata e Kuvendit, përmes një sistemi të integruar elektronik që pasqyron oraret e të gjitha komisioneve dhe angazhimet e përbashkëta të deputetëve. Një mekanizëm i tillë do të mundësonte identifikimin dhe shmangien paraprake të mbivendosjeve, duke ndihmuar në sigurimin e pjesëmarrjes, kuorumit dhe zhvillimit më të rregullt të punës së komisioneve.

Përbërja e komisioneve dhe ndikimi në procesin e planifikimit

Planifikimi dhe funksionimi i komisioneve parlamentare kërkojnë përfaqësimin e të gjitha grupeve parlamentare dhe komuniteteve, në mënyrë që prioritetet dhe aktivitetet e tyre të reflektojnë interesat dhe shqetësimet e ndryshme që përfaqësohen në Kuvend. Më 25 shtator 2026, Kryesia e Kuvendit dhe kryetarët e grupeve parlamentare diskutuan ndarjen e 16 komisioneve parlamentare, ndërsa më 28 shtator Kuvendi miratoi përbërjen dhe numrin e anëtarëve të tyre. Sipas vendimit, 15 komisione parashihej të kishin nga 11 anëtarë, ndërsa Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim 12 anëtarë.

Megjithatë, deri në fund të tetorit nuk ishte përmbyllur emërimi i të gjithë anëtarëve, pasi propozimet për

përfaqësuesit e Listës Serbe nuk morën mbështetjen e nevojshme. Sipas ndarjes së paraparë, ky subjekt duhej të përfaqësohej në të gjitha komisionet: me kryetarin dhe tre anëtarë në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me pozitën e zëvendëskryetarit të dytë në shtatë komisione dhe me nga një anëtar në tetë komisionet e tjera. Si rrjedhojë, këta përfaqësues nuk patën mundësi të merrnin pjesë në hartimin e planeve të punës dhe përcaktimin e prioriteteve të komisioneve.

Mospërfshirja e përfaqësuesve të komuniteteve kufizon mundësinë që interesat, nevojat dhe shqetësimet e tyre të paraqiten drejtpërdrejt në diskutimet parlamentare. Kjo mund të ndikojë në mënyrën se si komisionet përcaktojnë prioritetet, shqyrtojnë projektligjet dhe mbikëqyrin institucionet, duke lënë jashtë vëmendjes çështje që prekin drejtpërdrejt komunitetet joshumicë. Për më tepër, mungesa e këtij kontributi që në fazën e planifikimit i kufizon mundësitë për të identifikuar me kohë ndikimet që politikat dhe ligjet mund të kenë te këto komunitete. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, por edhe për komisionet e tjera që trajtojnë fusha me ndikim në jetën e tyre.

Ndikimi i përbërjes jo të plotë është vërejtur edhe në funksionimin e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. Gjatë tetorit, dy mbledhje të këtij komisioni, të planifikuara për 14 dhe 21 tetor, nuk u mbajtën për shkak të mungesës së kuorumit. Megjithatë, moskompletimi i përbërjes nuk mund të konsiderohet si shkaku i vetëm i mungesës së kuorumit, pasi pjesëmarrja e anëtarëve të tjerë mund të kishte mundësuar zhvillimin e mbledhjeve.

Përbërja e plotë e komisioneve është e rëndësishme jo vetëm për përfaqësimin politik dhe komunitar, por edhe për gjithëpërfshirjen e procesit të planifikimit dhe vendimmarrjes parlamentare. Për këtë arsye, emërimet duhet të përmbyllen pa vonesa të mëtejshme, në mënyrë që të gjitha komunitetet të kenë mundësi të përfaqësohen dhe të kontribuojnë në përcaktimin e prioriteteve dhe ushtrimin e përgjegjësive të komisioneve.

Kapacitetet administrative dhe mbështetja profesionale e komisioneve

Zbatimi i planeve të punës nuk varet vetëm nga planifikimi dhe pjesëmarrja e deputetëve, por edhe nga kapacitetet administrative dhe profesionale që mbështesin komisionet. Sipas të dhënave të siguruara, dhjetë komisione kanë nga dy zyrtarë mbështetës, tri komisione kanë nga tre zyrtarë, ndërsa tri të tjera kanë vetëm nga një zyrtar. Për më tepër, pesë zyrtarë janë të angazhuar në mbështetjen e nga dy komisioneve, çka nënkupton se koha dhe angazhimi i tyre duhet të ndahen ndërmjet dy strukturave parlamentare.

Zyrtarët mbështetës kanë rol të rëndësishëm në përgatitjen dhe organizimin e punës së komisioneve, përfshirë përgatitjen e materialeve për mbledhje, mbështetjen e shqyrtimit të projektligjeve, dokumentimin e diskutimeve dhe përcjelljen e aktiviteteve të planifikuara. Përgjegjësitë e tyre nuk kufizohen vetëm në punën e rregullt të komisioneve, por shtrihen edhe në mbështetjen e grupeve punuese, si dhe të komisioneve hetimore dhe komisioneve ad hoc, kur këto themelohen. Këto angazhime shtesë kërkojnë kohë dhe përgatitje administrative e profesionale, duke ndikuar në ngarkesën e përgjithshme të stafit. Për këtë arsye, numri i zyrtarëve dhe shpërndarja e përgjegjësive duhet të jenë në përputhje me fushëveprimin, ngarkesën dhe kompleksitetin e punës së secilit komision.

Të dhënat tregojnë dallime në raportin ndërmjet aktiviteteve të planifikuara dhe stafit në dispozicion. Komisioni për Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë mbulon një fushëveprim të gjerë dhe ka planifikuar 26 aktivitete, por mbështetet nga vetëm dy zyrtarë. Komisioni për Ekonomi ka planifikuar 24 aktivitete dhe ka tre zyrtarë mbështetës, ndërsa Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka planifikuar 11 aktivitete, përfshirë shqyrtimin e raporteve institucionale, por ka vetëm një zyrtar. Këto të dhëna ngrenë çështjen e përputhjes së kapaciteteve administrative me ngarkesën dhe përgjegjësitë e komisioneve.

Angazhimi i një zyrtari në mbështetjen e dy komisioneve paraqet një sfidë shtesë, veçanërisht kur mbledhjet, afatet dhe detyrat e tyre përkojnë. Në këto raste, kapaciteti i njëjtë administrativ duhet të mbulojë kërkesat e dy komisioneve, duke krijuar mundësi për vonesa në

përgatitjen e materialeve dhe përcjelljen e aktiviteteve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për komisionet që kanë ngarkesë të lartë legjislative ose mbikëqyrëse, si dhe për ato që angazhohen në procese shtesë përmes grupeve punuese apo komisioneve të posaçme.

Prandaj, Kuvendi duhet të shqyrtojë shpërndarjen e stafit në bazë të ngarkesës dhe fushëveprimit të komisioneve, duke marrë parasysh edhe angazhimet në grupet punuese dhe komisionet e posaçme. Ky vlerësim duhet të shërbejë edhe për të përcaktuar nëse kapacitetet aktuale janë të mjaftueshme apo nëse nevojitet rritja e numrit të zyrtarëve mbështetës në komisionet me ngarkesë më të madhe. Meqenëse këta zyrtarë janë pjesë e administratës publike të Kuvendit dhe ushtrojnë funksione profesionale e administrative, është e rëndësishme të sigurohen edhe mundësi të vazhdueshme për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre profesionale.

Gjetjet e kësaj analize tregojnë se sfidat në organizimin e punës së Kuvendit nuk lidhen vetëm me mungesën e kalendarit mujor apo me vonesat në miratimin e planeve të komisioneve. Ato ndërlidhen me një sërë faktorësh që ndikojnë në mënyrën se si përcaktohen prioritetet, shpërndahet ngarkesa ndërmjet komisioneve dhe deputetëve, koordinohen aktivitetet dhe sigurohen kapacitetet për realizimin e tyre. Mungesa e një kornize të përbashkët planifikimi, bartja e vazhdueshme e pikave të papërfunduara në seancat plenare, përbërja jo e plotë e disa komisioneve dhe mbivendosja e orareve tregojnë se organizimi i punës ende mbështetet në një qasje të fragmentuar. Në këto rrethana, planet e punës rrezikojnë të mbeten dokumente formale nëse nuk shoqërohen me mekanizma konkretë koordinimi dhe përcjelljeje.

Për të kaluar drejt një planifikimi më të integruar dhe funksional, nevojiten disa ndryshime konkrete:

Hartimi dhe zbatimi i një Plani të Integruar të Punës së Kuvendit: Kuvendi duhet të hartojë dhe zbatojë një Plan të Integruar të Punës për sesionin ose vitin parlamentar, i cili të jetë realist, transparent dhe të përfshijë aktivitetet e Kryesisë, seancave plenare dhe komisioneve parlamentare. Plani nuk duhet të jetë vetëm përmbledhje e planeve individuale, por një qasje e përbashkët planifikimi, e bazuar në prioritete të qarta legjislative dhe mbikëqyrëse, me afate, përgjegjësi dhe mekanizma për përcjelljen e zbatimit. Në këtë kuadër, duhet të sigurohet koordinimi i kalendarëve, përcjellja e pikave të papërfunduara dhe shmangia e mbivendosjeve në agjendat parlamentare. Po ashtu, planifikimi duhet të mbështetet nga përdorimi më i madh i teknologjisë informative dhe inteligjencës artificiale, përmes kalendarëve dhe tabelave digjitale të monitorimit, si dhe digjitalizimit të dokumenteve, arkivave dhe materialeve hulumtuese, me qëllim të organizimit dhe matjes më efikase të punës parlamentare. Për këtë qëllim, Kryesia duhet të përmbushë rregullisht edhe detyrimin për miratimin dhe publikimin e kalendarit mujor të punimeve, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Rritja e kapaciteteve institucionale për zbatimin e planit: Kuvendi duhet të vlerësojë nëse kapacitetet administrative, profesionale dhe teknologjike janë të mjaftueshme për realizimin e Planit të Integruar të Punës. Ky vlerësim duhet të përfshijë shpërndarjen e zyrtarëve mbështetës sipas ngarkesës së komisioneve, nevojën për rritjen e numrit të tyre dhe sigurimin e trajnimeve të vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve profesionale. Gjithashtu, duhet të investohet në digjitalizimin e proceseve të planifikimit, koordinimit dhe raportimit, përmes një sistemi të integruar që mundëson përcjelljen e aktiviteteve dhe shkallës së realizimit të tyre.

Sigurimi i përfaqësimit dhe shpërndarjes së balancuar të angazhimit të deputetëve: Kuvendi duhet të përmbyllë me kohë emërimin e të gjithë anëtarëve të komisioneve, duke siguruar përfaqësimin e grupeve parlamentare dhe komuniteteve në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes. Njëkohësisht, shpërndarja e deputetëve në komisione duhet të marrë parasysh ngarkesën e tyre dhe mundësinë reale për pjesëmarrje në mbledhje, në mënyrë që përgjegjësitë të mos përqendrohen te një numër i kufizuar deputetësh dhe të sigurohen kushtet për funksionimin e rregullt të komisioneve.

Përmbajtja e planeve të komisioneve parlamentare:- Komisionet duhet të hartojnë plane pune që përcaktojnë qartë objektivat, aktivitetet, afatet dhe rezultatet e pritshme, duke siguruar balancë ndërmjet funksionit ligjvënës, mbikëqyrjes parlamentare dhe përfshirjes së qytetarëve e grupeve të interesit. Përveç shqyrtimit të projektligjeve, planet duhet të përfshijnë aktivitete konkrete për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, shqyrtimin e raporteve institucionale, raportimet e ministrave, vizitat në terren dhe organizimin e dëgjimeve publike. Po ashtu, duhet të parashohin mekanizma për përcjelljen e realizimit të aktiviteteve dhe raportimin periodik për progresin, vonesat dhe arsyet e mosrealizimit.

INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS